



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

**P. nr.187/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.B. nga Gj. dhe B.Z., për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1pika1.4 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP/II.nr.96/18 të datës 05.03.2018, në shqyrtimin gjyqësor fillestar të mbajtur më datë **01.10.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj, dhe të akuzuarve F.B. dhe B.Z., mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **F. B.**, nga Gj... , Rr” .....”nr. 446, i biri L. dhe i T. e gjinisë Gj. data e lindjes ... në Gj., ka të kryer shkollën e mesme , punëtor , e gjendjes së mesme ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i pa martuar ,nr. ID .....

I akuzuari **B. Z.** ,nga Gj. , Rr” .... ”p. ,i biri Sh.dhe i S. e gjinisë H data e lindjes ...., në Gj., ka të kryer shkollën e mesme , menaxher ,e gjendjes së mesme ekonomike , shqiptar ,shtetas i R. Kosovës , i pa martuar ,nr. ID.....

**I akuzuari F. B.:**

**Ë s h t ë f a j t o r :**

**Sepse:**

**I. Me datë 01.01.2018**,rreth orës **03.00 min**, në Gjakovë, Rr.”...”, në Gjakovë, saktësisht në lokalitetin “...”, i shkaktonte lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit B. Z., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshjeje që kishin lidhur me muzikën e cila ishte e lëshuar në lokalitetin “...” e sulmon të dëmtuarin duke e goditur me shishe qelqi në kokë, me ç’ rast të dëmtuarit i shkaktonte lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. B.N.-C., të dt.29.01.2018.

**-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1pika 1.4 të KPRK-ës .**

**I akuzuari B. Z. :**

## **Ë s h t ë f a j t o r :**

### **Sepse:**

**II.** Me atë, kohë dhe vend të njëjtë si në pjesën e I. të dispozitivit të kësaj aktakuze, shkakton lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit F.B., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin lidhur me muzikën e cila ishte e lëshuar në lokalitë "...” e sulmon të dëmtuarin duke e goditur me shishe qelqi në hundë, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. B. N.-C., të dt.29.01.2018.

**-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1pika 1.4 te KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4,41,43,46,73 , nenit 188par.1pika 1.4 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, te akuzuarve iu shqipton;

## **DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit **F.B.** , dënim me gjobë në shumë prej **200 (dyqind ) euro**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Të akuzuarit **B. Z.**, dënim me gjobë në shumë prej **200 (dyqind ) euro**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 15 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t’i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10 (dhjetë) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**

Të akuzuarit -dëmtuarit **F.B.** dhe **B.Z.**, për të realizuar kërkesën e vet pasurore -juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej nga **30,00 €**, shpenzimeve procedurale të paguajnë shumën prej nga **10,00 €** ( në emër të ekspertizës mjeko-ligjore )si dhe në emër të paushallit gjyqësor te paguaj shumën prej nga **20,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP/II.nr.96/18 të datës 05.03.2018, kundër të akuzuarve **F.B.**, nga Gj.dhe **B. Z.**nga Gj., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me të datë 01.10.2018, Prokurori i shtetit **Armend Zenelaj**, lexojë aktakuzën PP/II.nr.96/18 të datës 05.03.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë Aktakuzës.

I akuzuari F.B., gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se jam penduar për veprën e kryer në afekt ,premtimi se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme, kërkoj falje nga i dëmtuari për lëndimet e shkaktuara, andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, moshën time të re dhe të më shqiptojë një dënim më të butë.

I akuzuari B. Z. , gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se jam penduar për veprën e kryer në afekt ,premtimi se ne te ardhmen nuk do te përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme, kërkoj falje nga i dëmtuari për lëndimet e shkaktuara, andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, moshën time të re dhe të më shqiptojë një dënim më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit Armend Zenelaj, ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që të njëjtit janë të vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike të pranimi të fajësisë e i cili pranimi i fajësisë ka mbështetje ligjore në aktakuzë dhe në prova të mjaftueshme, andaj i propozojë gjykatës që të akuzuarit e lartcekur të shpallet fajtor, ti dënoj sipas ligjit dhe të njëjtit ti obligojë në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se të akuzuarit :**I.** F.B.a, me datë 01.01.2018, rreth orës 03.00 min, në Gjakovë, Rr. “...”, në Gjakovë, saktësisht në lokalit “...”, i shkakton lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit B.Z., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin lidhur me muzikën e cila ishte e lëshuar në lokalit “...” e sulmon të dëmtuarin duke e goditur me shishe qelqi në kokë, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. B.N.-C., të dt.29.01.2018, dhe **II.** B.Z., me datë, kohë dhe vend të njëjtë si në pjesën e I. të dispozitivit të kësaj aktakuze, shkakton lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit F.B., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin lidhur me muzikën e cila ishte e lëshuar në lokalit “...” e sulmon të dëmtuarin duke e goditur me shishe qelqi në hundë, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të konstatuara dhe të përshkruara hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. B. N.-C., të dt.29.01.2018.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bere në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe

për këtë ka vendosur që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe ta gjykohen në bazë të ligjit, me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga të akuzuarit, premtimin se nuk do të përsërisin vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga të dëmtuarit njëri-tjetrit për lëndimet e shkaktuara, pendimin e shprehur për veprën e kryer, sjelljet e kryesve në të kaluarën se më parë nuk kanë qenë të dënuar, sjelljen e tyre pas kryerjes së veprës penale të gjitha këto ndikuan që Gjkata ka ardhur në përfundim që të akuzuarve të i'u shqiptoj dënim me gjobë në shume prej **200 (dyqind) euro**, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera, shkallen e përgjegjësisë së të akuzuarve dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej nga 10.00 € dhe paushalli gjyqësor në shumë prej nga 20,00 € është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së., dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.187/18 më datë 01.10.2018**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.